



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Fakulteti i Edukimit

---

Këshilli i Fakultetit

Në mbështetje të nenit 16, pika 1 të Rregullores nr. 1201, dt. 11.09.2018 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”, Këshilli i Fakultetit të Edukimit, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.10.2020 nxjerr këtë:

**K O N S T A T I M**

1. Këshilli i Fakultetit të Edukimit shqyrtoi kryerjen e punëve në lidhje me raportin e komisionit recensues të formuar nga Këshilli i Fakultetit, në mbledhjen e mbajtur më 06.10.2020.
2. Këshilli i Fakultetit konstaton se raporti i komisionit recensues është i kompletuar dhe i përcjellë në zyrën për çështje akademike të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për publikim në Buletin, sipas afatetve të përcaktuara në Rregulloren nr. 1201, dt. 11.09.2018 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Bashkangjitur gjeni:

- Raportin e komisionit vlerësues: një mësimdhënës për lëndët Matematika Elementare I (O), Matematika elementare II (O), Metodologji e mësimit të matematikës I (O), Metodologji e matematikës II (O), Lojërat Matematikore (Z).

**I dorëzohet:**

Zyrës për çështje akademike  
Sekretarit të FEdu-ut,  
Arkivit të fakultetit,

Dekani  
Prof. Ass. Dr. Besim Gollopeni

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

Raporti i Komisionit recensus për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik sipas konkursit të datës 4.9.2020

UNIVERSITETI I MITROVICËS  
UNIVERSITY OF MITROVICA  
ISA BOLETINI  
REKTORATI

Pranuar me dt 06.10.2020			
Njesia org	Numer	Nr ekzempli	Vlera
	1315		



UNIVERSITETI I MITROVICËS  
UNIVERSITY OF MITROVICA  
ISA BOLETINI  
FAKULTETI I EDUKIMIT

Pranuar me dt 06.10.2020			
Njesia org	Numer	Nr ekzempli	Vlera
	309		

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE  
AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK.

Fakulteti	Edukimit
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	Një mësimdhënës për lëndët: Matematika elementare I (O), Matematika elementare II (O), Metodologji e mësimit të matematikës I (O), Metodologji e mësimit të matematikës II (O), Lojërat matematikore (Z).
Kandidatët e paraqitur:	1. Xhevdet Spahiu 2. Melinda Mula

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar	Prof.Ass. Dr. Eliza Avdiu
2. Anëtar	Prof. Asoc.Dr.Faton Merovci
3. Anëtar	Prof. Asoc.Dr. Ilmi Hoxha

**5. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)**

(Anetarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të shkurtër për titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre vetëm për një kandidat për një pozitë (ose për më tepër kandidatë, nëse ashtu është kërkuar me konkurs). Komisioni vlerësues përmbledh të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar dhe sjell konkludimin dhe propozimin e arsyetuar për kandidatin dhe titullin në të cilin propozohet (sipas kërkesave të konkursit, Statutit dhe pozitës së shpallur) për kandidatin i cili propozohet për pozitën e shpallur. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatet, ndërsa 4 kapitujt paraprake shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

**Komisioni Vlerësues** i formuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Mitrovicës 'Isa Boletini', me numër 247/4 të datës 11.09.2020, duke u bazuar në nenin 159 të Statutit të përkohshëm të UMIB – it, Rregullores për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emrimit të personelit akademik në UMIB, me nr. prot.1092 të datës 11.09.2018 si dhe konkursin publik të datës 04.09.2020, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve konstaton që:

1. Kandidati Xhevdet Spahiu ka dorëzuar në afat kohor kopjet fizike në fakultet ndërsa ato elektronike ka dërguar vetëm kërkesën (njëra për Fakultet të Edukimit dhe tjetra kërkesë për Fakultet të Gjeoshkencave) por dokumentacionet tjera të kërkuara në konkurs mungojnë.
2. Kandidatja Melinda Mula ka dërguar kopjet fizike me postë brenda afatit kohor ndërsa dokumentacionin në formë elektronike e ka dërguar dy ditë pas mbylljes së konkursit respektivisht me datë 23.09.20.

Referuar KONKURSIT për emërtimin dhe avancimin e personelit akademik në Unëversitetin e Mitrovices "Isa Boletini":

**V. Mënyra e aplikimit**

1. Aplikantet duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe elektronike.
2. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet dhe të arkivohet në Fakultetin përkatës, kurse versioni elektronik në platformën online të Universitetit të Mitrovicës [Konkursi.personeliakademik2020@umib.net](mailto:Konkursi.personeliakademik2020@umib.net)
3. Aplikimi përmes platformës elektronike online do të fillojë nga data 7.9.2020

4. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet) ndërsa për libra të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).


5. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartëcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

6. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, përkatësisht nga data 7.9.2020 deri më 21.9.2020, deri në orën 16:00.


SI PERFUNDIM: Komisioni vlerësues konstatoi se asnjëri nga kandidatët nuk plotëson kriteret për shqyrtimin e dokumentave.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:  
[të shënohet thirrja e saktë akademike]


1. Prof. Dr. Eliza Avdiu- Kryetar/e



2. Prof. Asoc. Dr. Faton Merovci - Anëtar/e



3. Prof. Asoc. Dr. Ilmi Hoxha - anëtar/e



Datë: 05/10/ 2020